



REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

MAMUŠA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUSHËS
OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUSA



B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES¹

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik

Titulli i kontratës: “Ndërtimi i urës në Leshka Komuna e Mamushës”

Numri i aktivitetit të prokurimit:

Nr ² i prokurimit	626-22-5977-5-2-1
Nr i brendshëm	626-22-017-521

Nr.	Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Vlera totale e ofertave
1.	Grup i Operatorëve Ekonomik BAJRAM HA.GASHI B.I.; GASHI ING SH.P.K, Dubravë, pn, 23000, Suharekë	71,278.50
2.	Ridvan Elezi B.I., Pellazgët 18A, 20000, Prizren	59,388.07
3.	Grup i Operatorëve Ekonomik ACTIVA GROUP SH.P.K.; Benita Company, RR.BRIGABA 123 P.N, 23000, SUHAREKE	60,336.86
4.	Grup i Operatorëve Ekonomik: AAB CONSTRUCTION SH.P.K.; Bujar Shabani B.I., LUAN HARADINAJ SOL 1 HY.1 NR.4, -, PRISHTINË	72,682.00

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

Komuna e Mamushës-Zyra e Prokurimit shpërblen me kontratë Grupin e Operatorëve Ekonomik të përgjegjshëm me çmimin më të ulët “AAB CONSTRUCTION” SH.P.K. & Bujar Shabani B.I. LUAN HARADINAJ SOL 1 HY.1 NR.4, -, PRISHTINË në vlerë totale të ofertës prej 72,682.00 €.

Data: 02.08.2022

Emri dhe mbiemri i ZPP: Gazmend Gashi

Nënshkrimi:

Këshillë juridike: Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj janë shkelur nga vendimi i autoritetit kontraktues gjatë kryerjes së këtij aktiviteti të prokurimit, mund të bëjë kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 në adresën e Autoritetit Kontraktues, përmes platformës elektronike.

¹ Këtij formulari i bashkëngjiten edhe letrat standarde të njoftimeve: B42, B45 dhe B46. (shtoni letra njoftuese sipas nevojës).

² Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



B42 Letër standarde për tenderuesin e eliminuar ³

Mamushë me: 02.08.2022

Komuna e Mamushës – Zyra e Prokurimit Mamushë

Për: Grupin e Operatorëve Ekonomik “BAJRAM HA.GASHI” B.I. & “GASHI ING” SH.P.K,
Dubravë, pn, 23000, Suharekë

Nr. i prokurimit ⁴	626-22-5977-5-2-1
Nr i brendshëm	626-22-017-521

Titulli:

“Ndërtimi i urës në Leshka Komuna e Mamushës”

I nderuar z. Bajram Gashi

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim “LPP”.

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

Nuk e keni dorëzuar:

☐ Certifikatat apo dëshmitë e kërkuara të cilat tregojnë apo pohojnë se nuk jeni i diskualifikuar nga ndonjë masë nën Nenin 65 të LPP;

☐ Certifikatën, dokumentin ose ndonjë dëshmi tjetër të mjaftueshme të kërkuar sipas Nenit 66 të LPP për të dëshmuar përshtatshmërinë profesionale tuaj;

³ Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtutjeshme ngase kanë qenë të pa përgjegjshëm dhe të parregullt.

⁴ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me aktivitetin e prokurimit.

☐ Dëshmi të mjaftueshme, siç është përshkruar në nenet 68 dhe 69 të LPP, që tregojnë arsyeshëm se i përmbush kërkesat minimale të kapacitetit profesional, financiar dhe teknik të saktësuara në dosjen e tenderit apo në njoftimin e kontratës.

Tenderi i juaj është i papërgjegjshëm:

- ☐ Nuk i keni përmbushur kërkesat e sigurisë së tenderit;
- ☐ Nuk e keni plotësuar dhe nënshkruar si duhet *Formularin për dorëzimin e tenderit*.
- ☐ Nuk i keni përmbushur kërkesat e vlefshmërisë së tenderit;
- ☐ Nuk e keni paraqitur numrin e mjaftueshëm të kopjeve të kërkuara;
- ☒ Nuk e keni paraqitur deklaratën për specifikimet teknike të objektit të ofruar të kontratës;
- ☐ Nuk e keni paraqitur deklaratën e cila identifikon nënkontraktuesit e zgjedhur për aktivitetin relevant të prokurimit;
- ☐ Nuk e keni plotësuar numrin e kërkuar të punëtorëve të kërkuar (minimumi 5 punëtor).
- ☐ Nuk keni paraqitur dëshmitë e kërkuara për mjetet dhe pajisjet teknike për realizimin e kontratës.
- ☐ Nuk keni ofruar dëshmitë në lidhje me kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare
- ☐ Nuk e keni paraqitur planin dinamik për kryerjen e punëve sipas specifikimit teknik

[Në rast të Grupit të Operatorëve Ekonomik] N/A

ARSYETIM

Ju jeni diskualifikuar për këto arsye :

Në dosje të tenderit tek Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE TË TENDERIT (FTD) në nenin 3.1 Specifikacionet teknike të detyrueshme është paraqitur kushti si vijon:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë:

a. Deklaratën për specifikacionet teknike për furnizimet (materiale) e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit (Të plotësohet, nënshkruhet dhe vulolet aneksi nr. 2 i kësaj dosje të tenderit).

Deklarata për specifikacion teknik është kërkesë administrative e paraparë në nenin 2.5 të dosjes së tenderit e cila obligon O.E. që të deklaroj se do të përmbahet specifikacioneve teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit.

Në nenin 39.8 të Rregullave dhe Udhëzuesit të Prokurimit në paraqitje tabelore, shprehimisht është cekur se OE duhet të dorëzoj specifikimin e detajuar të mallrave të ofruara. Përveç në rastet kur OE nuk mund të dorëzoj specifikimin teknik të një produkti të caktuar p.sh. peme/perime etj. OE dorëzon deklaratën ku deklaron se mallrat do të jenë në përputhje me specifikimin e kërkuar. Në të kundërtën është paraparë që të refuzohet tenderi pa kërkuar informacione shtesë.

Ju me tenderin tuaj nuk keni dorëzuar një deklaratë të tillë.

Lëshimet e cekura më lartë kanë bërë që ju të eliminoheni nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në tenderin në fjalë

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtoni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit .

Me respekt,

Gazmend Gashi

_____,
(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)


(Nënshkrimi)



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



B42 Letër standarde për tenderuesin e eliminuar ⁵

Mamushë me: 02.08.2022

Komuna e Mamushës – Zyra e Prokurimit Mamushë

Për: Operatorin Ekonomik Ridvan Elezi B.I., Pellazgët 18A, 20000, Prizren

Nr. i prokurimit ⁶	626-22-5977-5-2-1
Nr i brendshëm	626-22-017-521

Titulli:

“Ndërtimi i urës në Leshka Komuna e Mamushës”

I nderuar z. Ridvan Elezi

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim “LPP”.

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

Nuk e keni dorëzuar:

- ☐ Certifikatat apo dëshmitë e kërkuara të cilat tregojnë apo pohojnë se nuk jeni i diskualifikuar nga ndonjë masë nën Nenin 65 të LPP;
- ☐ Certifikatën, dokumentin ose ndonjë dëshmi tjetër të mjaftueshme të kërkuar sipas Nenit 66 të LPP për të dëshmuar përshtatshmërinë profesionale tuaj;

⁵ Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtejshme ngase kanë qenë të pa përgjegjshëm dhe të parregullt.

⁶ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me aktivitetin e prokurimit.

☐ Dëshmi të mjaftueshme, siç është përshkruar në nenet 68 dhe 69 të LPP, që tregojnë arsyeshëm se i përmbush kërkesat minimale të kapacitetit profesional, financiar dhe teknik të saktësuara në dosjen e tenderit apo në njoftimin e kontratës.

Tenderi i juaj është i papërgjegjshëm:

- ☐ Nuk i keni përmbushur kërkesat e sigurisë së tenderit;
- ☐ Nuk e keni plotësuar dhe nënshkruar si duhet **Formularin për dorëzimin e tenderit**.
- ☐ Nuk i keni përmbushur kërkesat e vlefshmërisë së tenderit;
- ☐ Nuk e keni paraqitur numrin e mjaftueshëm të kopjeve të kërkuara;
- ☐ Nuk e keni paraqitur deklaratën për specifikimet teknike të objektit të ofruar të kontratës;
- ☐ Nuk e keni paraqitur deklaratën e cila identifikon nënkontraktuesit e zgjedhur për aktivitetin relevant të prokurimit;
- ☐ Nuk e keni plotësuar numrin e kërkuar të punëtorëve të kërkuar (minimumi 5 punëtor).
- ☐ Nuk keni paraqitur dëshmitë e kërkuara për mjetet dhe pajisjet teknike për realizimin e kontratës.
- ☐ Nuk keni ofruar dëshmitë në lidhje me kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare
- ☒ Nuk e keni paraqitur planin dinamik për kryerjen e punëve sipas specifikimit teknik.

[Në rast të Grupit të Operatorëve Ekonomik] N/A

ARSYETIM

Ju jeni diskualifikuar për këto arsye :

Në dosje të tenderit tek Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE TË TENDERIT (FTD) në nenin 5.2 Afatet kohore për fillimin dhe / ose përfundimin e kontratës, si dhe në nenin III. 1. 3 Kushtet e tjera të veçanta me të cilat ka të bëjë ekzekutimi i kontratës, është paraqitur kushti si vijon:

-Operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë tender janë të obliguar që të hartojnë planin dinamik për ekzekutim të kontratës sipas specifikave teknike të kërkuara në dosjen e tenderit.

- Plani dinamik nuk duhet të jetë më i gjatë se 60 (Gjashtëdhjetë) ditë pune nga data e marrjes së urdhërblërjes nga Autoriteti Kontraktues.

-Në rast të mos përmbushjes së këtij kushti O.E. do të konsiderohet si i pa përgjegjshëm, oferta do të refuzohet dhe do të qojë në eliminimin e operatorit ekonomik.

Ju me tenderin tuaj nuk keni dorëzuar një plan dinamik të tillë.

Lëshimet e cekura më lartë kanë bërë që ju të eliminoheni nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në tenderin në fjalë

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit .

Me respekt,

Gazmend Gashi

(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)

Gashi
(Nënshkrimi)



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



B42 Letër standarde për tenderuesin e eliminuar ⁷

Mamushë me: 02.08.2022

Komuna e Mamushës – Zyra e Prokurimit Mamushë

Për: Grupin e Operatorëve Ekonomik “ACTIVA GROUP SH.P.K. & “Benita Company”,
RR.BRIGABA123 P.N, 23000, SUHAREKE

Nr. i prokurimit ⁸	626-22-5977-5-2-1
Nr i brendshëm	626-22-017-521

Titulli:

“Ndërtimi i urës në Leshka Komuna e Mamushës”

I nderuar z. Fisnik Berisha

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim “LPP”.

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

Nuk e keni dorëzuar:

☐ Certifikatat apo dëshmitë e kërkuara të cilat tregojnë apo pohojnë se nuk jeni i diskualifikuar nga ndonjë masë nën Nenin 65 të LPP;

☒ Certifikatën, dokumentin ose ndonjë dëshmi tjetër të mjaftueshme të kërkuar sipas Nenit 66 të LPP për të dëshmuar përshtatshmërinë profesionale tuaj;

⁷ Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtejshme ngase kanë qenë të pa përgjegjshëm dhe të parregullt.

⁸ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me aktivitetin e prokurimit.

☒ Dëshmi të mjaftueshme, siç është përshkruar në nenet 68 dhe 69 të LPP, që tregojnë arsyeshëm se i përmbush kërkesat minimale të kapacitetit profesional, financiar dhe teknik të saktësuara në dosjen e tenderit apo në njoftimin e kontratës.

Tenderi i juaj është i papërgjegjshëm:

- ☐ Nuk i keni përmbushur kërkesat e sigurisë së tenderit;
- ☐ Nuk e keni plotësuar dhe nënshkruar si duhet **Formularin për dorëzimin e tenderit**.
- ☐ Nuk i keni përmbushur kërkesat e vlefshmërisë së tenderit;
- ☐ Nuk e keni paraqitur numrin e mjaftueshëm të kopjeve të kërkuara;
- ☒ Nuk e keni paraqitur deklaratën për specifikimet teknike të objektit të ofruar të kontratës;
- ☐ Nuk e keni paraqitur deklaratën e cila identifikon nënkontraktuesit e zgjedhur për aktivitetin relevant të prokurimit;
- ☒ Nuk e keni plotësuar numrin e kërkuar të punëtorëve dhe inxhinierëve.
- ☒ Nuk keni paraqitur dëshmitë e kërkuara për mjetet dhe pajisjet teknike për realizimin e kontratës.
- ☒ Nuk keni ofruar dëshmitë në lidhje me kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare
- ☐ Nuk e keni paraqitur planin dinamik për kryerjen e punëve sipas specifikimit teknik

[Në rast të Grupit të Operatorëve Ekonomik] N/A

ARSYETIM

Ju jeni diskualifikuar për këto arsye :

Në dosje të tenderit tek Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE TË TENDERIT (FTD) në nenin 3.1 Specifikacionet teknike të detyrueshme është paraqitur kushti si vijon:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë:

a. Deklaratën për specifikacionet teknike për furnizimet (materialet) e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit (Të plotësohet, nënshkruhet dhe vuloset aneksi nr. 2 i kësaj dosje të tenderit).

Deklarata për specifikacion teknik është kërkesë administrative e paraparë në nenin 2.5 të dosjes së tenderit e cila obligon O.E. që të deklaroj se do të përmbahet specifikacioneve teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit.

Në nenin 39.8 të Rregullave dhe Udhëzuesit të Prokurimit në paraqitje tabelore, shprehimisht është cekur se OE duhet të dorëzojë specifikimin e detajuar të mallrave të ofruara. Përveç në raste kur OE nuk mund të dorëzojë specifikimin teknik të një produkti të caktuar p.sh. peme/perime etj. OE dorëzon deklaratën ku deklaron se mallrat do të jenë në përputhje me specifikimin e kërkuar). Në të kundërtën është paraparë që të refuzohet tenderi pa kërkuar informacione shtesë.

Ju me tenderin tuaj nuk keni dorëzuar një deklaratë të tillë.

Gjithashtu në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë në nenin 8.1 & 8.2 Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare në pikën 1 është paraparë kërkesa si vijon:

1. Operatorët Ekonomik duhet të kenë një qarkullim financiar së paku 150,000.00 € në tri vitet e fundit.

Dhe si dëshmi është kërkuar:

1. Raportin, raportet apo vërtetimet përkatëse nga një ose më shumë banka ose deklaratat vjetore në ATK apo nga institucioni kompetent në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilat dëshmohet se O.E ka pasur një qarkullim financiar në tri vitet e fundit sipas kërkesës së lartshënuar.

Grupi i O.E. ka dorëzuar dëshminë për qarkullimin financiar por të një Operatori Ekonomik tjetër (Asfalt Group SHPK) i cili nuk ka qenë anëtarë i grupit në fjalë.

Gjithashtu në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale janë paraparë kërkesat si vijon:

2. OE duhet të kenë staf të mjaftueshëm të punëtorëve dhe inxhinierëve të kyçur në projekt, minimumi 10 punëtor të rregullt ose me parakontratë nga të cilët minimumi 2.1-Një (1) Inxhinier i Dip. i ndërtimtarisë ose master të përfunduar drejtimi hidroteknik –Kërkohet që inxhinieri të ketë min. 5 vite përvojë pune – në angazhimet profesionale. 2.2-Një (1) Inxhinier i Dip. i ndërtimtarisë ose master të përfunduar drejtimi konstruktiv –Kërkohet që inxhinieri të ketë min. 5 vite përvojë pune – në angazhimet profesionale. 2.3-Një inxhinier ose Bachelor i diplomuar në menaxhimin e emergjencave (mbrojtja në punë) –Kërkohet që inxhinieri të ketë min. 2 vite përvojë pune – në angazhimet profesionale. 2.4 Një inxhinier ose bachelor të licencuar të Gjeodezisë. Dhe si dëshmi është kërkuar:

2. Listën origjinale të punëtorëve të O.E. të nënshkruar dhe vulosur nga O.E. -Diplomat e inxhinierëve (kopje të noterizuar. Diplomat jashtë shtetit duhet të jenë të nostrifikuara) -Cv-të e inxhinierëve të nënshkruar nga inxhinieri (origjinal ose kopje të noterizuar)

Grupi i O.E. nuk i ka plotësuar kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të kërkuara më lartë pasi që nuk i ka plotësuar kërkesat në pikat: 2 nënpikat 2.1 pasi që nuk ka dorëzuar dokumentacionin për inxhinier të ndërtimtarisë drejtimi hidroteknik dhe në listën e stafit nuk figuron asnjë inxhinier i kësaj lëmie; 2.3 pasi që nuk e ka dorëzuar dokumentacionin për inxhinierin e emergjencave dhe në listën e stafit nuk figuron asnjë inxhinier i kësaj lëmie; 2.4 pasi që inxhinieri i paraqitur nga ana e grupit nuk e ka nënshkruar CV-në sikur është kërkuar në pikën 2.4 në dosje të tenderit;

Në nenin 39.8 të Rregullave dhe Udhëzuesit të Prokurimit në paraqitje tabelore, shprehimisht është cekur se nëse CV-a e kërkuar nuk i plotëson kërkesat refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm.

Gjithashtu në pikën 3. nënpikën 3.1 është kërkuar që O.E. duhet të caktoj me vendim ose të autorizoj menaxherin e kontratës për këtë projekt, i cili duhet të jetë inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose master të përfunduar (drejtimi hidroteknik), të ketë së paku 5 vite përvojë pune. Dhe si dëshmi është kërkuar:

3. Autorizimi ose vendimi për caktimin e menaxherit të projektit (Origjinal ose Kopje e noterizuar) -Diploma e inxhinierit (kopje e noterizuar. Diplomat jashtë shtetit duhet të jenë të nostrifikuara) -Cv e inxhinierit të nënshkruar nga inxhinieri (origjinal ose kopje e noterizuar)

Grupi i O.E. nuk ka dorëzuar kurrfarë dokumenti për caktimin e menaxherit të kontratës për këtë projekt.

Gjithashtu në pikën 4. është kërkuar që: 4. OE duhet të posedon makinerinë dhe mjetet e punës, të domosdoshme për realizim të projektit, së paku 4.1 1(një) eskavator minimumi 10 ton dhe një

eskavator minimumi 4 ton, 4.2 1(një) ngjeshës hidraulike për ngjeshje të dheut (ose montuese ne eskavator), 4.3 2(dy) kamionë të rëndë me peshë bartëse minimum 10 ton . Dhe si dëshmi është kërkuar:

4. Lista e makinerisë dhe mjeteve të punës që do të përdoret në realizim të projektit, me dokumentacion të pronësisë (Duhet të kopjohen Certifikatat e Regjistrimit të automjetit (CRA) të mjeteve ose dokumenti unik doganor (DUD) dhe të paraqiten me rastin e tenderimit) ose nëse merren në shfrytëzim (kontrata origjinale për shfrytëzim ose kopja e noterizuar si dhe dëshmitë e pronësisë së dhënësit në shfrytëzim të cekura më lartë)

Grupi i O.E. nuk e ka dorëzuar listën e makinerisë dhe mjeteve të punës që do të përdoren për realizimin e projektit. Gjithashtu nuk ka dorëzuar dokumentacion të pronësisë (kopjet e Certifikatave e Regjistrimit të automjetit (CRA) të mjeteve ose dokumenti unik doganor (DUD), por ka dorëzuar disa fatura dhe kontrata për disa automjete të kërkuara më lartë.

Lëshimet e cekura më lartë kanë bërë që ju të eliminoheni nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në tenderin në fjalë


Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit .

Me respekt,

Gazmend Gashi

_____,
(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)


(Nënshkrimi)



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



B45 - Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm⁹

Mamushë më: 02.08.2022

Komuna e Mamushës- Zyra e Prokurimit

Për: Grupin e Operatorëve Ekonomik AAB CONSTRUCTION SH.P.K.; Bujar Shabani B.I.,
LUAN HARADINAJ SOL 1 HY.1 NR.4, -, PRISHTINË

Nr i prokurimit	626-22-5977-5-2-1
Nr i brendshëm	626-22-017-521

Titulli: “Ndërtimi i urës në Leshka Komuna e Mamushës”

I nderuar Z. **Arlind Buzhala**

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim “LPP”. Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.

Kemi kënaqësinë të ju njoftojmë se ju keni dorëzuar **tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët**, si përgjigje ndaj **kërkesës për tenderin në lidhje me** aktivitetin e prokurimit të lartcekur.

Juve ju është dhënë kontrata me çmimin e saktësuar në tenderin tuaj dhe në pajtim me afatet dhe kushtet e dosjes së tenderit.


Dhënia e kontratës është e përkohshme dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuale deri në skadimit të intervalit, *gjatë të cilit ofertuesit e pasuksesshëm mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit*.

Bashkëngjitur me këtë letër është vendimi për dhënie të kontratës

Me respekt,

Gazmend Gashi

Emri dhe mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit


Nënshkrimi

⁹ Kjo letër është për ofertuesin të cilit i është dhënë kontrata